LIGJ
Nr. 94/2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9831, DATË 12.11.2007, "PËR DËMSHPËRBLIMIN E ISH TË DËNUARVE POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 17, 44, 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 12 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Në bazë të buxhetit vjetor, të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë nga regjimi komunist, do të ndahet, në mënyrë proporcionale, në një raport prej 70 për qind për të gjitha kategorinë e subjekteve përfituese parësore, të përcaktuara në paragrafin e dytë të këtij neni, dhe 30 për qind për trashëgimtarët e ish të dënuarve, që nuk bëjnë pjesë në këtë kategori, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i vogël se 100 000 (njëqind mijë) lekë dhe jo më i madh se 1 000 000 (një milion) lekë.

Me shlyerjen përfundimtare të dëmshpërblimit të subjekteve përfituese parësore, të përcaktuara sipas këtij neni, i gjithë buxheti vjetor kalon për dëmshpër-blimin e trashëgimtarëve të ish të dënuarve politikë.".

2. Pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Shpërndarja e dëmshpërblimit për kategorinë e subjekteve përfituese parësore, për të njëjtin këst, do të kryhet sipas kësaj radhe:

a) ish të dënuarat politike gra, që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës;

b) ish të dënuarit politikë, që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës dhe që kanë moshën mbi 75 vjeç me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

c) ish të dënuarit politikë, të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda, sipas përcaktimit të aktit nënligjor të posaçëm;

ç) ish të dënuarit politikë që jetojnë në momentin e dhënies së pagesës, të cilët, pavarësisht nga mosha, kanë pasardhës të radhës së parë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

d) ish të dënuarit politikë që nuk jetojnë dhe që kanë trashëgimtarë të radhës së parë, të cilët janë në moshë të mitur, me hyrjen në fuqi të këtij ligji;

dh) ish të dënuarit politikë që jetojnë, në momentin e dhënies së pagesës, dhe që kanë moshë nën 75 vjeç me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Me kryerjen e pagesës, për të gjitha subjektet parësore, brenda këstit më të ulët, fillon pagesa e këstit pasardhës e kështu me radhë.".

Neni 2

Në nenin 13, paragrafi i parë shfuqizohet.

Neni 3

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 14
Tërheqja e dëmshpërblimit

Struktura përgjegjëse për pagesën e dëmshpër-blimeve të ish të dënuarve politikë në Ministrinë e Financave publikon, në mënyrë periodike, në faqen zyrtare, listat e dosjeve të gatshme për pagesë dhe bën njoftimin për të gjitha subjektet përfituese, pjesë e listës, nëpërmjet shërbimit postar, njoftimit me mjete të komunikimit elektronik (e-mail) dhe medias publike.

Brenda një afati 3-mujor nga data e publikimit të listës, të gjithë ish të përndjekurit, të cilët janë pjesë e saj, duhet të dorëzojnë në strukturën përgjegjëse të Ministrisë së Financave dokumentet e parashikuara në aktet nënligjore që janë nxjerrë në zbatim të ligjit.

Kur një ish i dënuar politik ose trashëgimtari /trashëgimtarët e ish të dënuarit politik nuk dorëzon dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të parashikuar në paragrafin e mësipërm, ai/ajo njoftohet lidhur me përfundimin e këtij afati dhe i jepet një afat shtesë deri në 30 ditë. Në rast se dokumentacioni i kërkuar nuk dorëzohet edhe pas kalimit të afatit shtesë (30 ditë), pagesa i kalon personave që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore, të cilat, në përputhje me ligjin, kanë dorëzuar dokumentet e duhura dhe janë të gatshme për pagesë.

Kur një ish i dënuar politik ose trashëgimtari /trashëgimtarët e ish të dënuarit politik refuzon të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda afateve të parashikuara si më sipër, forma e refuzimit duhet të jetë me shkrim. Edhe në këtë rast, pagesa i kalon personave që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve përfituese parësore, të cilat, në përputhje me ligjin, kanë dorëzuar dokumentet e duhura dhe janë të gatshme për pagesë.

Personat, të cilët nuk dëmshpërblehen, për shkak të mosplotësimit të dokumenteve, gëzojnë të drejtën për të marrë këstin e kësaj pagese në fazën tjetër, por jo më vonë se tre vjet pas publikimit të emrit për herë të parë në faqen zyrtare. Me kalimin e kësaj periudhe (3 vjet), personi që nuk ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, humbet të drejtën e dëmshpërblimit.".

Neni 4

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 15
Forma e pagesës

Forma e pagesës përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.".

Neni 5

Neni 16 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 32, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:
"Këshilli i Ministrave, brenda vitit 2014, miraton afatet dhe skemën e shpërndarjes së fondeve.".

Neni 7

Neni 33 shfuqizohet.

Neni 8
Aktet nënligjore

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, udhëzimin sipas përcaktimeve të bëra në nenin 4, të këtij ligji.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 24.7.2014

KRYETARI
Ilir Meta